

DEKLARATË

Dekretimi sa më parë i Datës së Zgjedhjeve, domosdoshmëri për të mos vënë nën stres procesin përgatitor dhe atë ligjzbatues në Procesin Zgjedhor për Kuvendin të vitit 2025

Data 10 dhjetor 2024 është afati i fundit ligjor i përcaktuar nga Kodi Zgjedhor për nxjerrjen e Dekretit të Presidentit të Republikës për të shpalluar datën¹ e Zgjedhjeve për Kuvendin të pranverës 2025, pasi mandati² i Kuvendit aktual mbaron më datën 10 shtator 2025³.

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) vlerëson **deklarimin dhe qasjen e Presidentit të Republikës se caktimi i datës së zgjedhjeve nuk është thjesht një detyrim kushtetues dhe as procedurë formale juridike**, sikurse edhe mesazhet e tjera të shprehura në mesazhin e publikuar⁴ prej tij mbas përfundimit të procesit të konsultimeve për caktimin e datës së zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2025.

Një qasje proaktive kjo, të cilin KRIIK e mbështeti dhe e nxiti të çohet më tej në bashkëbisedimin e frytshëm që zhvilloi me Shkëlqesinë e Tij z. President dhe Stafin e tij⁵, më datë 11 nëntor 2025, duke vënë theksin, ndër të tjera, tek **nevoja për një interesim të vazhdueshëm të Institucionit të Presidentit në zbatimin e ligjit prej institucioneve shtetërore të ngarkuara me detyra** lidhur me procesin zgjedhor, në përmbushje edhe të gërmës “h” të nenit 92 të Kushtetutës.

Në këtë takim, ndër të tjera, KRIIK theksoi **nevojën e dekretimit sa më parë të datës së zgjedhjeve, pasi një sërë procesesh, mekanizmash dhe afatesh lidhen me datën e shpalljes së Dekretit.**

¹Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998, [Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë](#). Pjesa e katërt “Presidenti i Republikës”, Neni 92, gërma “gj”.

² Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998, [Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë](#), Pjesa e tretë “Kuvendi”, Kreu I “Zgjedhja dhe afati”, Neni 65, pika 1 “Kuvendi zgjidhet çdo 4 vjet. Mandati i Kuvendit fillon me mbledhjen e parë të tij pas zgjedhjeve dhe përfundon në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të katërt nga data e mbledhjes së parë. Në çdo rast, Kuvendi qëndron në detyrë deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri të zgjedhur.”

³ Kuvendi i Shqipërisë, faqja zyrtare në fejsbuk: [Mbledhjet Seanca e parë Plenare e Legjislaturës së X](#), datë 10 Shtator 2021.

⁴ Faqja zyrtare e internetit të Institucionit të Presidentit, “[Mesazhi i Presidentit të Republikës](#), Sh. T. Z. Bajram Begaj, në përmbyllje të procesit të konsultimeve për caktimin e datës së zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2025”, publikuar më datë 25.11.2024.

“... Caktimi i datës së zgjedhjeve për mua nuk është thjesht një detyrim kushtetues dhe as procedurë formale juridike, por është, së pari, një sprovë e fuqishme bashkëpunimi, mirëkuptimi dhe angazhimi i të gjithë faktorit politik dhe institucional në emër të zgjedhësve dhe për zgjedhësit, sikurse është një rast domethënës për të risjellë në vëmendje rëndësinë vendimtare që kanë zgjedhjet për konsolidimin e demokracisë parlamentare.

Detyra madhore e aktorëve politikë është t’i shndërrojnë zgjedhjet parlamentare të pranverës së vitit 2025 në histori suksesi për shqiptarët dhe demokracinë shqiptare, ku duhet të shkëlqejë zbatimi i ligjit, korrektesa dhe etika në komunikimin e platformave, respekti për zgjedhësit dhe vullnetin e tyre të shprehur me votë.”

⁵ TV ABC News AL, “[Presidenti Begaj takim me përfaqësues të KRIIK: Shoqëria civile të angazhohet në mbikëqyrjen e zgjedhjeve](#)”, publikuar më datë 11.11.2024.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

KRIIK shpreh rezervat e tij lidhur me këtë vonesë të shpalljes së dekretit mbi datën e zgjedhjeve parlamentare 2025.

Kjo vonesë, megjithëse jo në shkëlqje të ligjit, **konstatohet e pakuptimtë, ndërkohë që po sjell një sërë efektsh dhe pasojash jo-pozitive** lidhur me cilësinë e procesit të ardhshëm zgjedhor dhe respektimin e kuadrit ligjor.

Vonesa e deritanishme apo edhe e mëtejshme e mosshpalljes së Dekretit po çon, së pari, në zhbërjen e tërë procesit konsultues me partitë politike, duke limituar natyrshëm dhe logjikisht datat e zgjedhjeve në dispozicion, e **duke u limituar vetëm në datën e fundit të periudhës zgjedhore,** që është data 11 maj 2025, datë e kontestuar publikisht prej partive opozitare.

Shpallja e vonuar e Dekretit po fut në “stres test” tërë përgatitjen e procesit të ardhshëm zgjedhor, proces i cili parashikon miratimin e një volumi të tërë aktesh, ndërkohë që edhe zbatimi i tyre me korrektësi kërkon kohën e nevojshme në dispozicion, pa folur këtu për ngarkesën që mbart aplikimi për herë të parë i votimit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë.

Neni 27 i Kodit Zgjedhor në pikën 1 të tij përcakton se miratimi i Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet e ardhshme, duhet të bëhet jo më vonë se 9 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, pra jo më vonë se data 10 dhjetor 2024. Ky vendim nuk mund të merret pa u caktuar më parë me Dekretin data e zgjedhjeve, dekret i cili i hap rrugë tërë miratimit të akteve rregullatore nënligjore të nevojshme për përgatitjen dhe realizimin e procesit zgjedhor 2025.

Theksohet këtu se ndryshimi i mundshëm i kufijve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, **nëse Presidenti do të shpallë një nga tre datat e para të periudhës zgjedhore, do të bëhet nga Komisioni Rregullator në shkëlqje të Kodit Zgjedhor,** pasi neni 27 pika 5 e tij përcakton se ky vendim duhet të merret jo më vonë se 5 muaj para datës së zgjedhjeve⁶.

Nga ana tjetër, **caktimi i monitoruesve, që do të vëzhgojnë respektimin e detyrimeve të subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore,** duke përfshirë respektimin e ndalimeve dhe kufizimeve **të formave të caktuara të fushatës dhe shpërdorimit të burimeve shtetërore,** i parashikuar të bëhet jo më vonë se gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve, sipas nenit 92/4 të Kodit Zgjedhor, **është tashmë në shkëlqje të ligjit.** Edhe nëse datë zgjedhjeve do të shpallej data e fundit, pra 11 maj 2025, ky proces duhet të kishte përfunduar përpara datës 11 nëntor 2024.

Sillet në vëmendje, gjithashtu, se kjo vonesë e shpalljes së dekretit, **lë shumë pak kohë për procesin e verifikimit dhe pastrimit të listave të zgjedhësve,** duke lënë mundësi për publikimin e vetëm tre ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë, **kohë e pamjaftueshme në gjykimin e KRIIK, për kontrollin dhe saktësimin e listave të zgjedhësve nisur nga problematikat e shumta të mbartura nga proceset e mëparshme zgjedhore, e sidomos ato të zgjedhjeve vendore 2023.**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

⁶ Nëse Dekreti do të shpallë si Datë të Zgjedhjeve Parlamentare datën 20 prill 2025, afati i fundit i marrjes së këtij vendimi do të ishte data 19 nëntor 2024; - nëse si Datë e Zgjedhjeve do të dekretohet data 27 prill 2025, afati i fundit i marrjes së këtij vendimi do të ishte data 26 nëntor 2024; - nëse si Datë e Zgjedhjeve do të dekretohet data 4 maj 2025, afati i fundit i marrjes së këtij vendimi do të ishte data e sotme, 3 dhjetor 2024.

Në përfundim, **KRIIK i bën thirrje urgjente Presidentit të Republikës të shpallë sa më parë Dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2025, në ushtrim të drejtë të kompetencave dhe përgjegjësisë të tij.**

Tiranë, më 3 Dhjetor 2024!

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania